



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Bazuar në nenin 8 pika 3.1, nenit 6 pika 5 dhe nenit 33 të Ligjit Nr.04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2012 për kushtet dhe Mënyrën e Ofrimit të të Dhënave të Fituara me Përpunime të Veçanta të Statistikave Zyrtare si dhe nenit 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, *Agjencia e Statistikave të Kosovës bënë:*

Shpalljen e Konkursit Publik për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Emri i Institucionit	<i>Agjencia e Statistikave të Kosovës</i>
Titulli i punës:	Anketues për Anketën e Ekonomive Bujqësore 2018 (AEB 2018)
Numri i referencës:	ASK-DSBM-001
Tarifa e shërbimit:	I negociuar
Raporton te:	Zyra rajonale dhe direkt te njësia e Anketës së Ekonomive Bujqësore në ASK
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta-(MSHV)
Kohëzgjatja e kontratës:	Një (1) muaj
Orari i punës:	I plotë
Lokacioni dhe numri i ekzekutuesve:	ASK- 5 anketues

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Të marrin pjesë në trajnime dhe të njihen me Udhëzimet Metodologjike dhe Organizative (Të dhënat e anketës, dhe të jenë të përgatitur për realizimin e Anketës së Ekonomive Bujqësore (Anketimin e EB-ve) në terren bazuar në udhëzimet për anketën AEB 2018;
- Të zhvillojnë grumbullimin e të dhënave për anketën e AEB 2018 përmes pyetësorëve të AEB 2018.
- Të respektoj udhëzimet e pyetësorit për pyetjet që janë në pyetësor dhe të ndjekin të gjitha procedurat dhe sqarimet e përshkruara në udhëzime;
- Para largimit nga ekonomia bujqësore të bëjnë kontrollimin e pyetësorit të plotësuar për t'u siguruar se të gjitha pyetjet janë plotësuar dhe të gjitha udhëzimet janë ndjekur;
- Përdorimi i adresave dhe hartave (hartat vetëm në rastet problematike përdoren) për qarqet regjistruese dhe ekonomitë bujqësore të caktuara;
- Të njoftojnë mbikëqyrësit për problemet dhe pasiguritë e mundshme dhe të kërkojnë ndihmë nëse është e nevojshme;
- Intervista zhvillohet në gjuhën të cilën e flet ai komunitet.
- Të bëjnë raportimin ditor të mbikëqyrësi (zyra rajonale);
- Të përfundojnë Anketa e Ekonomive Bujqësore brenda afatit.
- Të mbajë të gjitha informatat e pranuar në Ekonomit Bujqësore të Anketuara si konfidenciale.

Përgatitja shkollore për anketues/përvoja:

- Të jete student (studentët e fakultetit te bujqësisë) kanë përparësi;
- Të kenë përvojë në anketat e mëparshme në bujqësi dhe në regjistrimin e bujqësisë 2014;
- Përparësi kanë kandidatet të cilët kanë kryer nivel më të lartë të shkollimit;

Kompetenca dhe aftësitë:

- Aftësi dhe bashkëpunim shumë të mirë për të komunikuar;
- Të jenë të gatshëm për punë ekipore;
- Aftësi të orientimit në hapësirë (përdorimi i hartave në hapësirë për identifikimin e objekteve të banimit);
- Të ketë aftësi të mira organizative dhe të jetë i gatshëm të punoj nganjëherë me orë pune më të gjatë përfshi vikendet.
- Të jetë nga komuna ku kërkohet të zhvillohet AEB.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore (mbi 18 vjet) të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Konkursi është i hapur 3 ditë kalendarike nga dita e publikimit në mjetet e informimit dhe në Web-faqen e ASK-së.

Numri i anketuesve sipas komunave

Komuna	Numri i anketuesve
Skenderaj	3
Kaçanik dhe Hani i Elezit	1
Glllogvc	1
Gjithsej	5

Paraqitja e kërkesave: Formularët për aplikim mund të merren në Arkivin e ASK-së, ose mund të shkarkohet nga web faqja e ASK-së në adresën <http://ask.rks-gov.net/> Aplikacionet dorëzohen në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, Rr.”Zenel Salihu” nr.4 Prishtinë.

Aplikacionit duhet t’i bashkëngjiten: CV¹, kopja e letërnjoftimit, dokumenti mbi vendbanimin, vërtetimi nga fakulteti që është student, diploma (të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje), si dhe një dëshmi nga përvoja e punës sipas përshkrimit të detyrave të punës (Anketa e bujqësisë ,RB-2014).

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të nënshtrohen intervistës me gojë.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni në zyrën e personelit, në tel: 038- 200 31 149 prej orës 08:00 – 16: 00.

¹ Përfshi: Nr. Telefonit si dhe një adrese elektronike